

V E N D I M
Nr. 524, datë 21.9.2000

**PËR PËRCAKTIMIN E TERMAVE DHE KUSHTEVE TË BONOVE TË THESARIT PËR
DETYRIMET E SHTETIT NDAJ BANKËS KOMBËTARE TREGTARE, SH.A.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të seksionit 4.02, shkronja “f”, të marrëveshjes së shitjes së aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare, miratuar me ligjin nr.8634, datë 6.7.2000, “Për miratimin e marrëveshjes së shitjes së aksioneve të shoqërisë anonime Banka Kombëtare Tregtare, sh.a., ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kent Bank, Koorporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC), si dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Detyrimi i shtetit kundrejt Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a., për shumën
3 039 242 000 lekë, të bëhet nëpërmjet emitimit të bonove të thesarit sipas termave, kushteve dhe karakteristikave të mëposhtme:

a) Emetuesi:	Ministria e Financave
b) Lloji i letrave me vlerë:	Bono thesari
c) Forma e emitimit:	Me vlerë të skontuar në formë regjistrimi në Bankën e Shqipërisë
ç) Data e emitimit:	6 korrik 2000
d) Shuma e emitimit:	3 039 242 000 lekë
dh) Afati i maturimit:	6 muaj, me të drejtë rinovimi
e) Norma e interesit	E barabartë me nivelin mesatar të YILD-it të bonove të thesarit me afat 6-mujor të ankandeve më të afërta para dhe pas datës 6 korrik 2000 për periudhën e investimit. Pas kësaj periudhe bonot e thesarit do të riinvestohen në ankandet e rradhës, sipas procedurave normale.
ë) Tregtueshmëria	Bonot mund të shiten apo të skontohen nga mbajtësi, sipas zhvillimit të gjendjes monetare dhe pozicioneve të likuiditeteve të sistemit bankar në përgjithësi dhe të bankave në veçanti, por jo para datës 31.12.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta